



Nr: 11/ _____

Mëz, _____

PRANUAR NË:

ACCEPTED ON: 14-05-2023

PRIMLJENO:

Mr.No./Br: 11/ 1331

Në bazë të nenit 68 paragrafi 1, pikën 1 dhe 2 të nenit 69 Themelimi i marrëdhënies së punës të Ligjit për Zyrarët Publik Nr.06/L-114, në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212,(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), neni 5 pikës c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr.04/L-032, të datës 29.08.2011 Udhëzimit Administrativ (MPMS)Nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik, Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 05/2021 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpallë:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësimit	Numri i pozitave	Orë
1	SHFMU" Habib Berisha" në Gurbardh	Klasorë	Me kohë të caktuar	1	20
2	SHFMU" 12 Prilli" në Vermicë	Klasorë	I lirë	1	20

I. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet, si vijon:

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në KK Malishevë);
- Dokumenti personal kopje (letërnjoftim ose pasaportë);
- Rezymeja personale (CV);
- Diplomat e kualifikimit;
- Certifikata (certifikata në vend të diplomës duhet të jenë jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj nga data e diplomimit);
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës së punës në institucionet edukative arsimore (nëse ka);
- Çertifikata e lindjes

II. Kushtet dhe Kualifikimi:

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2021 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të përgjithshëm.

III. Vlerësimi i kandidatëve

- Me këtë konkurs do të zhvillohen procedurat e rekrutimit
- Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim.
- Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë.
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhen në pozitat e lartpërmendura;
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave, rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të shpallen në web-faqen zyrtare të Komunës të Malishevës;



IV. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrës për Shërbim me Qytetar në Komunën e Malishevës objekti i ri i Komunës;
- Data e njoftimit në web faqen; <https://kk.rks-gov.net/malisheve/category/shpalljet/>, <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>, është prej datës; 14.09.2023 deri me datën, 28.09.2023, ndërsa data e aplikimit është nga data, 29.09.2023 deri me datën, 13.10.2023,
- Rezultatet shpallën në linkun: <https://kk.rks-gov.net/malisheve/category/shpalljet/konkurset/>
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave që duhet të jenë të noterizuara me rastin e aplikimit.
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Nëse aplikohet për dy pozita a më shumë, kandidatët duhet të dorëzojnë aplikacione të veçanta;
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse

Vërejtje: Data e njoftimit do të mbetet 15 ditë për arsye të mos na paraqiten vonesa të shumta në proqesit edukativo arsimor për vitin shkollor 2023/2024.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen

Në mungesë të kandidatëve me kualifikim përkatës, do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.

Themelimi i marrëdhënies së punës:

Marrëdhënia e punës themelohet vetëm nga dita e nënshkrimit të kontratës së punës.

Drejtoria për Arsim dhe Edukim

Arbëreshë Krasniqi

